



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:051588

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05632831

KPPP.nr.1768/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.P.N. “Euroing” SH.P.K., me NUI:811302281, me seli në Rahovec, fshati Xërxë, kundër debitorit Komuna e Gjakovës, me seli në Gjakovë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.90/21 të datës 04.03.2021, të Përmbartuesit Privat Gjokë Radi, me seli në Gjakovë, jashtë seancës me datë 29.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Gjakovës dhe Urdhri Përmbartimor P.nr.90/21 i datës 04.03.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N.P.N. “Euroing” SH.P.K., ka caktuar urdhrin P.nr.90/21 të datës 04.03.2021, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.100025 të datës 19.11.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që t’i paguaj kreditorit borxhin në shumë të përgjithshme prej 74,556.94 €, me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e lëshimit të faturës e deri në pagesën definitive si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, me ndalimin dhe transferimin e të hollave në llogarinë e kreditorit, regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme deri në vlerën e borxhit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar ndër të tjerash se për shkak të pandemisë COVID19, nuk ka qenë në gjendje të paguaj pjesën e zotuar të mjeteve, mes kreditorit dhe debitorit ekziston kontrata e lidhur me numër 02 – 410-0417722 të datës

02.08.2017, nga e cila rrjedh edhe një marrëveshje dytësore për financimin e shumës së paraparë nga debitori, nga kjo marrëveshje kuptohet se Ministria e Shëndetësisë do t'i paguaj debitorit shumën prej 200,000.00 €, ndërsa pjesën e mbetur prej 24,000.00 € do ta paguaj kreditori. Tutje ka shtuar se debitori nuk ka arritur që të planifikoj në buxhetin e këtij viti këtë borxh, andaj ka kërkuar afat shtesë për ta përmbushur obligimin. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet.

Kreditori në përgjigjen në prapësimin të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim duke theksuar se debitori nuk e ka arsyetuar me asnjë fakt se nuk është në gjendje ta paguaj borxhin ndaj kreditorit. Tutje ka shtuar se pretendimi i debitorit se ka një marrëveshje me ministrin e shëndetësisë nuk ka të bëjë me kreditorin, pasi që debitori ka realizuar pagesa për faturat e tjera, ndërsa pretendimi i debitorit se nuk ka planifikuar buxhet për pagesën e borxhit ndaj kreditorit është i pa pranueshëm dhe i pa bazuar në ligj. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të zbatohet përmbarimi.

Gjykata Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPP.nr.121/21, të datës 02.11.2021, e ka refuzuar prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër urdhrimit përmbarimor P.nr.20/21 të datës 04.03.2021, të lëshuar nga Përmbaruesi Privat Gjokë Radi.

Debitori me datë 12.11.2021, ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes të dispozitave të procedurës përmbarimore, konstatim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Gjykatës së Apelit, që të aprovohet ankesa, ndërsa aktvendimi i shkallës së parë të prishet.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr.88/23 të datës 05.09.2023, ka aprovuar si të themeltë ankesën e debitorit, ka anuluar aktvendimin e atakuar dhe çështja i është kthyer Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që

gjenden në shkresat e lëndës, vërejtjeve sipas aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr.100025 e datës 19.11.2020, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Fatura Nr.100025 e datës 19.11.2020, në bazë të së cilës është mbështetur propozimi për përmbartim dhe është lejuar urdhri përmbartimor është bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar siç kërkohet me nenin 37 të LPP-së.

Në këtë drejtim, rezulton se propozimi për përmbartim mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri, përmban të meta ngase në propozim nuk janë treguar dokumentet origjinale apo kopja e vërtetuar mbi bazën e të cilës është iniciuar procedura përmbartimore, ashtu siç përcaktohet me dispozitën nga neni 38 paragrafi 1 i LPP-së: i cili përcakton se *“Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..”*.

Sipas nenit 43, par.4 të LPP-së përcaktohet se: *“...Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbartueshmërisë së nxjerrë nga përmbartuesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbartimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbartuesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbartim nga përmbartuesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”*

Andaj, nga të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbartimit P.nr.90/21 i datës 04.03.2021, është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përmbartim nuk i është bashkangjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit të besueshëm dhe rrjedhimisht propozimi për përmbartim përmban të meta në kuptim të nenit 38 paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrimit.

Meqenëse në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrimit për përmbartim, ndërsa organi përmbartues - përmbartuesi privat, nuk ka vepruar konform nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në rast se propozimi për përmbartim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbartues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”*, gjykata shfuqizoi urdhrin përmbartimor dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1768/23, datë 29.04.2024

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.